

Statistikat e Transportit Hekurudhor

Metadata Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure

(ESMS)

INSTAT

Metadata Referenciale

1. Kontakt	2
2. Përditësimi i metadatave	2
3. Paraqitja statistikore.....	2
4. Njësia matëse	4
5. Periudha e referencës	4
6. Mandati institucional	4
7. Konfidencialiteti	4
8. Politika e botimit.....	5
9. Shpeshësia e shpërndarjes.....	6
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia	6
11. Manaxhimi i cilësisë	7
12. Rëndësia.....	7
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	8
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	8
15. Koherenca dhe Krahasueshmëria.....	8
16. Kostoja dhe ngarkesa	9
17. Rishikimi i të dhënave	9
18. Përpunimi statistikor	9
19. Komente.....	10
Aneks	10

1. Kontakt	
1.1. Institucioni i kontaktit	Instituti i Statistikave, INSTAT
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Statistikave të R&D, Inovacionit, Teknologjisë së Informacionit dhe Transportit, Drejtoria e Statistikave Ekonomike.
1.3. Personi i kontaktit	Olsa Ulqinaku
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Specialist, Sektori i Statistikave të R&D, Inovacionit, Teknologjisë së Informacionit dhe Transportit.
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Nd.35, H.1 Njësia Administrative Nr.2, Kodi Postar 1017, Tiranë
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	agaqi@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 2222411 / +(355) 4 2233356
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 2228300
2. Përditësimi i metadatave	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	27.10.2023
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	27.10.2023
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	27.10.2023
3. Paraqitja statistikore	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	<p>Statistikat e Transportit Hekurudhor përfshijn informacion mbi flukset e mallrave dhe numrit të pasagjerëve sipas transportit hekurudhor. Këto statistika përfshijnë informacione për:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Lëvizjen e numrit të pasagjerëve me hekurudhë; • Volumin e mallrave; • Volumin e mallrave sipas klasifikimit NST 2007; • Volumin e eksport/importeve të mallrave me hekurudhë.

<p>3.2. Sistemi i klasifikimit</p>	<p>Për klasifikimin e mallrave sipas mënyrave të ndryshme të transportit përdoret Klasifikimi Standard i Mallrave për Statistikat e Transportit i cili njihet shkurt si klasifikimi NST 2007. Ky klasifikim përdoret për mallrat e transportuara me hekurudhë.</p> <p>NST 2007 është plotësisht i ndërlidhur me Klasifikimin e Produkteve dhe Aktiviteteve, CPA 2008 dhe Nomenklaturën e Aktiviteteve Ekonomike (NVE Rev. 2). Rrjedhimisht, NST 2007 është gjithashtu në përputhje me klasifikimet homologe të Kombeve të Bashkuara (CPC dhe ISIC) dhe Nomenklaturën e Kombinuar (CN) 2007.</p> <p>Ky klasifikim mund të gjendet në linkun më poshtë: Nomenklatura Standarde e Mallrave për Statistikat e Transportit.</p>
<p>3.3. Mbulimi i sektorit</p>	<p>Informacioni statistikor mbulon të dhënat për Transportin Hekurudhor të kryer në Republikën e Shqipërisë.</p>
<p>3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime</p>	<p><u>Transport Hekurudhor</u></p> <p>Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve që përdorin një automjet Hekurudhor në një rrjet të caktuar Hekurudhor.</p> <p>Gjatësia e shinave - Për një seksion të caktuar Hekurudhor është gjatësia midis pikës së mesme të ndërtesës së stacionit të nisjes dhe pikës së mesme të ndërtesës së stacionit të terminalit.</p> <p>Pasagjerë të transportuar me hekurudhë - Do të quhet çdo pasagjerë që udhëton me mjetin Hekurudhor, duke përjashtuar personat e destinuar për shërbime në tren.</p> <p>Ton-kilometër (TKM) - Njësia e matjes që përfaqëson lëvizjen e një ton kapaciteti të disponueshëm në një vagon kur kryhet shërbime për të cilat është përcaktuar një distancë kryesisht mbi një kilometër.</p> <p>Mallra të transportuara me hekurudhë - Do të quhet çdo lëvizje malli që kryhet me mjet Hekurudhor, duke përfshirë këtu ambalazhin dhe pajisjet siç janë konteinerët, paletet si dhe mjetet rrugore të mallrave të transportuara me hekurudhë.</p> <p>Tren-kilometër - janë distancat në kilometra të përshkuara nga trenat.</p> <p><u>Eksportet/importet e mallrave</u></p> <p>Eksportet - Janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të rieksportuar pas përpunimit aktiv.</p> <p>Importet - Janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.</p>
<p>3.5. Njësia statistikore</p>	<p>Njësitë statistikore sipas llojeve të transportit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Hekurudha Shqiptare dhe ndërmarrjet private që operojnë në

	<p>aktivitetin e Transportit Hekurudhorë;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndërmarrjet eksportuese/importuese të cilat kryejnë aktivitet në transportin hekurudhorë.
3.6. Popullata statistikore	Popullata statistikore përfshin numrin e pasagjerëve dhe volumin e mallrave me hekurudhë, të kryer nga hekurudha shqiptare.
3.7. Zona e referencës	Të dhënat e statistikave të transportit hekurudhorë, mbulojnë të gjithë territorin e vendit.
3.8. Mbulimi në kohë	Statistikat e Transportit datojnë prej vitit 1993.
3.9. Periudha bazë	Nuk aplikohet.
4. Njësia matëse	Të dhënat mbi statistikave të transportit hekurudhor publikohen vetëm në vlera absolute dhe përqindje. Njësia matëse në transportin hekurudhor, për pasagjerët është numri i pasagjerëve dhe pasagjerë për kilometer, ndërsa për mallrat është ton dhe ton - km për ngarkim/shkarkimin e mallrave.
5. Periudha e referencës	Periudha referuese e informacionit statistikor mbi Statistikat e Transportit hekurudhor është tremujore. Ky raport i përket vitit referencë 2023.
6. Mandati institucional	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Baza ligjore në nivel kombëtar për prodhimin e indikatorëve për statistikave të Transportit janë: <ul style="list-style-type: none"> • Ligjin Nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”; • Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare 2022-2026; • Vendimet e Këshillit të Statistikave. ➤ Sipas rregulloreve përkatëse të BE-së janë: <ul style="list-style-type: none"> • Rregullorja e Parlamentit dhe Këshillit Evropian Nr. 2018/643 “Mbi Statistikat e Transportit”
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	Statistikat e Transportit nuk transmetohen në EUROSTAT. Aktualisht, INSTAT plotëson një sërë pyetësorësh të organizmave ndërkombëtare në lidhje me statistikave të transportit, të tilla si: Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën (UNECE), Federata Ndërkombëtare e Rrugëve (IRF), Common Questionnaire, etj.
7. Konfidencialiteti	
7.1. Konfidencialiteti - politika	Të dhënat e mbledhura konsiderohen rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligj Nr.

	<p>17/2018 "Për Statistikat Zyrtare, si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave Personale". Neni 31, i Ligjit Nr 17/2018, "Për Statistikat Zyrtare" përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.</p>
<p>7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave</p>	<p>INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhënat që ka mbledhur ose që ka akses, të cilat mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të njësive statistikore. INSTAT ndërmerr të gjitha masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësisë statistikore, shpërndahen nga INSTAT vetëm në rast se:</p> <p>a) Këto të dhëna janë trajtuar, siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në Rregullore, këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor; ose</p> <p>b) Njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave;</p> <p>Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT-it vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë akses tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojë shkallën e detajimit që mund të shpërndahet dhe të bëhet publike nga INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomandojë se: në cilin nivel detajimi mund të shpërndahen të dhënat statistikore, në mënyrë që identifikimi i drejtpërdrejtë ose indirekt, i njësisë statistikore të vrotuar të mos jetë i mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë përdoruesve; dhënia e hyrjes për hulumtuesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.</p>
<p>8. Politika e botimit</p>	
<p>8.1. Kalendari i publikimeve</p>	<p>Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit, në fund të vitit paraardhës. Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendar. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.</p>
<p>8.2. Aksesit në kalendarin e publikimeve</p>	<p>Kalendari i publikimeve është në dispozicion në faqen e internetit të INSTAT-it.</p>
<p>8.3. Aksesit i përdoruesve</p>	<p>Në përputhje me nenin 34 të Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, statistikave zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë dhe të përdoren të gjitha format e</p>

	<p>mundshme të mediave. INSTAT dhe agjencitë statistikore, që kanë në program përgjegjësitë e shpërndarjes, kërkojnë të plotësojnë çdo kërkesë të ndonjë organizate ose individit për të dhëna të pabotuara ose analiza specifike. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit janë si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Website – press release; 2. Kërkesat e shkruara; 3. Publikimi “Statistikat e Transportit” 4. Kërkesa për të dhëna, seksioni për përdoruesit e jashtëm.
9. Shpeshhtësia e shpërndarjes	Statistikat e transportit hekurudhor shpërndahen në baza tremujore dhe vjetore.
10. Aksesit në të dhëna dhe qartësia	
10.1. Njoftim për media	<p>Njoftimi për shtyp përmban informacion në lidhje me treguesit kryesorë të statistikave të transportit hekurudhor:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Volumi i mallrave të transportuar me hekurudhë; • Numri i pasagjerëve që udhëtojnë me hekurudhë; • Treguesit e volumit të eksport/importit të mallrave me hekurudhë; • Volumi i mallrave sipas klasifikimit NST 2007. <p>Njoftimi për shtyp në lidhje me statistikave të transportit publikohet online në faqen e internetit të INSTAT.</p>
10.2. Publikime	<p>Statistikat e transportit hekurudhor gjenden të botuara në botimin “Shqipëria në Shifra”. Përdoruesit mund t’i gjejnë rezultatet në faqen e internetit të INSTAT:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Statistikat e Transportit • Shqipëria në Shifra
10.3. Baza e të dhënave on-line	Të dhënat mbi statistikave të transportit hekurudhor publikohen në faqen zyrtare të INSTAT në seksionin: Databaza .
10.4. Aksesit në të dhënat mikro	Të dhënat nuk bëhen të disponueshme në nivel mikro, si pasojë e ruajtjes së konfidencialitetit. Të dhënat e agreguara, janë lloji i vetëm i të dhënave që ofrohet për përdoruesit e jashtëm. Këto të dhëna i jepen përdoruesve në rast se nuk janë konfidenciale bazuar në nenin 31, Ligji Nr. 17/2018, "Për Statistikat Zyrtare".
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një sesiioni të dedikuar për Kontakt .
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Metodologjia është e bazuar në manualët dhe rregulloret e EUROSTAT mbi Statistikat e Transportit, të cilat përmbajnë një set të gjerë rekomandimesh mbi plotësimin e treguesve për llojet e ndryshme të transportit. Në faqen e

	<p>INSTAT ka një seksion lidhur me Metodologjinë e përdorur mbi statistikat e transportit.</p>
10.7. Dokumentimi i cilësisë	<p>Sektori i Statistikave të R&D, Inovacionit, Teknologjisë së Informacionit dhe Transportit dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat e ndjekura lidhur me statistikat e transportit hekurudhor për qëllime të brendshme.</p>
11. Manaxhimi i cilësisë	
11.1. Sigurimi i cilësisë	<p>INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në Ligjin Nr.17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT, për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.</p>
11.2. Vlerësimi i cilësisë	<p>Të dhënat e transportit krahasohen me të dhënat e transportit të një viti më parë për të dalluar nëse ka koherencë të dhënash apo ka pasur ndryshime të mëdha.</p>
12. Rëndësia	
12.1. Nevojat e përdoruesit	<p>Përdoruesit e të dhënave të transportit janë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Institucione të administratës publike • Universitete • Organizata jo fitimprurëse kombëtare dhe ndërkombëtare • Biznese • Kërkues shkencorë, studentë dhe grupe të tjera të ngjashme.
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	<p>Klikime (Page Views) në lidhje me statistikat e transportit për vitin 2022 janë rreth 2.071 klikime.</p> <p>Gjatë 2022, INSTAT ka kryer vrojtimin për matjen e kënaqësisë së përdoruesve nga publikimet e INSTAT. Rezultatet e vrojtimit tregojnë se cilësia e përgjithshme mbi “Statistikat e Transportit” është vlerësuar me 3,69 (73.8%) nga një shkallë prej 1 (shumë dobët) në 5 (shumë mirë).</p> <p>INSTAT organizon çdo vit Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve</p>

12.3. Plotshmëria	<p>Plotshmëria e të dhënave të Transportit hekurudhor, gjykohet duke krahasuar cilësinë dhe sasinë e treguesve të mbuluar nga INSTAT nga ato të kërkuara nga rregulloret e ndjekura.</p> <p>Shkalla e plotshmërisë së të dhënave për statistikat e transportit hekurudhor, është afërsisht 40%.</p>								
13. Saktësia dhe besueshmëria									
13.1. Saktësia e përgjithshme	<p>Të dhënat për transportin hekurudhor mblidhen në mënyrë administrative në zbatim të bazës ligjore dhe Memorandumeve të Mirëkuptimit. Nuk kryhen vrojtime për të dhënat e transportit. Në përgjithësi, të dhënat janë kontrolluar me vitet e mëparshme për të identifikuar ndonjë ndryshim të rëndësishëm në ecurinë e të dhënave.</p>								
13.2. Gabim i kampionimit	<p>Nuk aplikohet pasi të dhënat janë administrative.</p>								
13.3. Gabim jo i kampionimit	<p>Sa i përket gabimeve të jo kampionimit, fjala është kryesisht për disa gabime në raportimin e të dhënave nga burimet administrative. Rishikimi i të dhënave ndodh vetëm në rast se institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT për efekt përditësimi apo ndonjë gabim të mundshëm human. Nëse institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT, atëherë në publikimin më të afërt do të pasqyrohen këto ndryshime dhe do të jepet një informacion i shkurtër sqarues për përdoruesit.</p>								
14. Afatet kohore dhe përpikmëria									
14.1. Afatet kohore	<p>Rezultatet e statistikave të transportit hekurudhor janë publikuar në faqen e internetit të INSTAT 27 ditë pas përfundimit të periudhës referuese (T+27 ditë).</p> <table border="1" data-bbox="555 1417 1074 1541"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>9/30/2023</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>10/27/2023</td> </tr> <tr> <td>Afatet kohore</td> <td>27</td> </tr> </table>	Periudha referuese	9/30/2023	Data e publikimit	10/27/2023	Afatet kohore	27		
Periudha referuese	9/30/2023								
Data e publikimit	10/27/2023								
Afatet kohore	27								
14.2. Përpikmëria	<p>Të dhënat për statistikat e transportit hekurudhor publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve. Publikimi i statistikave të transportit ka qënë i përpiktë në kohë në 100 % të publikimeve të kryera gjatë viteve.</p> <table border="1" data-bbox="555 1704 1074 1845"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>9/30/2023</td> </tr> <tr> <td>Data e shpallur</td> <td>10/27/2023</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>10/27/2023</td> </tr> <tr> <td>Vonesa në kohë</td> <td>0</td> </tr> </table>	Periudha referuese	9/30/2023	Data e shpallur	10/27/2023	Data e publikimit	10/27/2023	Vonesa në kohë	0
Periudha referuese	9/30/2023								
Data e shpallur	10/27/2023								
Data e publikimit	10/27/2023								
Vonesa në kohë	0								
15. Koherenca dhe Krahasueshmëria									
15.1. Krahasueshmëria gjeografike	<p>Të dhënat që INSTAT prodhon janë hartuar në përshtatje me metodologjinë</p>								

	e EUROSTAT. Statistikat e transportit hekurudhor prodhohen në nivel vendi.
15.2. Krahasueshmëria kohore	<p>Informacioni statistikor i transportit grumbullohej në mënyrë tremujore duke filluar nga viti 1993 deri në 2016. Nga viti 2016-2022, të dhënat janë publikuar çdo muaj, duke siguruar një krahasueshmeri kohore prej 7 vitesh (CC2=Jlast-Jfirst+1=7).</p> <p>Nga viti 2023 e në vazhdim të dhënat publikohen çdo tremujor.</p>
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	Nuk aplikohet.
15.4. Koherenca e brendshme	Përpara finalizimit të të dhënave, kontrollohet konsistenca e brendshme e tyre. Kontrollohen gjithashtu lidhjet midis variablave dhe koherenca e tyre në seri të ndryshme.
16. Kostoja dhe ngarkesa	Stafi i përfshirë në përgatitjen e statistikave të transportit pranë Sektorit të Statistikave të R&D, Inovacionit, Teknologjisë së Informacionit dhe Transportit është: 1 punonjës pranë zyrave qendrore të INSTAT.
17. Rishikimi i të dhënave	
17.1. Politika e rishikimit	<p>Politikat e rishikimit të statistikave të transportit hartohen në përputhje me politikën e rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të vendosura nga INSTAT. Për më shumë, referohuni:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Politika e revizionimit • Politika e trajtimit të gabimeve
17.2. Praktika e rishikimit	<p>Në rast se autoritetet lokale do të raportojnë ndryshime në tabelat e dërguara pranë INSTAT, informacioni përditësohet dhe publikohet në publikimin e muajit të ardhshëm shoqëruar me një shënim sqarues për përdoruesit.</p> <p>Nuk janë kryer rishikime të të dhënave mbi “Statistikat e Transportit” për vitin 2023, subjekt i këtij raporti.</p>
18. Përpunimi statistikor	
18.1. Burimi i të dhënave	Burimi i vetëm i të dhënave të transportit është burimi administrativ. Të dhënat grumbullohen nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Mbulimi është në nivel vendi, të dhënat janë administrative dhe informacioni statistikor mundësohet në kohë.
18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave	Të dhënat mbi statistikave të transportit hekurudhor grumbullohen në baza mujore.

18.3. Grumbullimi i të dhënave	Të dhënat e transporti hekurudhor janë të dhëna administrative. Informacioni statistikor grumbullohet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe detajohet sipas transportit të mallrave dhe pasagjerëve, eksport/importit të mallrave, në frekuencë mujore.
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	Të dhënave të transportit hekurudhor ju kryhen kontrole logjike dhe matematike. Këto kontrole realizohen për të gjithë treguesit të cilët INSTAT publikon, gjatë të gjithë procesit të përpunimit të të dhënave.
18.5. Përpilimi i të dhënave	Nuk aplikohet.
18.6. Rregullimi	Nuk aplikohet.
19. Komentë	
Aneks	